



01/Nr. 3405 /2026
Data: 14.04.2026

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e tretë -III- për vitin 2026 e Komitetit për Politik dhe Financa, mbajtur me datë 23.03.2026 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetarë i Komunës), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Senad Kalisi** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Bajrush Laçi** (Udhëheqës i Zyrës Ligjore), **Ajete Berisha** (Udhëheqëse e Personelit), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2025.
3. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2025.
4. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson: për pikat e të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson: propozoj që për mbledhjen e kuvendit të komunës të shtohet edhe një pikë e rendit të punës dhe si të doni ta titulloni, qoftë raport apo informatë mbi problemin e shkollës së mesme "Dardania", për përjashtimin masovik të nxënësve prej shkollës. Kërkoj nga Drejtoria e Arsimit që të vijë në kuvend me një informatë apo raport shumë të saktë. Është mirë që ne, si anëtarë të kuvendit, të dimë saktë pse ka ardhur deri te kjo. Për t'i pasur informatat e sakta, është mirë që të bëhet një listë e nxënësve me emër dhe mbiemër dhe në cilën klasë janë, me çfarë suksesi kanë ardhur prej klasës nëntë, a janë zhvilluar të gjitha procedurat deri te përjashtimi.

Kryesuesi thekson: është shqetësim me vend dhe të përjashtohen tridhjetë nxënës nuk është mirë, por unë mendoj që në kuvend mund të kërkosh në rend të ditës për të diskutuar, ose e diskutojmë te të ndryshmet në mbledhje të kuvendit.

Menduh Vlasi thekson: nëse mbetet te të ndryshmet, ne nuk kemi informata; është mirë që qysh këtu të rekomandojmë që në mbledhjen e kuvendit të shtohet edhe kjo pikë.

Kryesuesi thekson: e diskutojmë te pika e pestë, te të ndryshmet. Në mbledhjen e kaluar të kuvendit, z. Basri Dernjani e diskutoi çështjen për ngritjen e pagave për punëtorët e NPL "Pastrimi" dhe kërkoi që në rend të punës të hyjë si pikë shtesë propozim-vendimi për rritjen e buxhetit të NPL "Pastrimi" Sh.A. A keni edhe ndonjë diskutim për pikat e rendit të punës dhe për pikën shtesë? Nëse nuk ka, e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025.
3. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025.
4. Propozim-vendim për rritjen e buxhetit të NPL "Pastrimi" Sh.A.
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin. Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson: në raport të komitetit më shumë shënohet se është biseduar, por nuk janë marrë informata kthyesë që, kur të bisedohet me një drejtori për një çështje, a ka pasur sukses për atë çështje që është biseduar apo vetëm ka mbetur si diskutim. Është një gabim teknik, se kur është zëvendësuar kryesuesi i Komitetit për Komunitete, shënohet që me vota anonime; është mirë të përmirësohet.

Kryesuesi thekson: a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson: gjatë vitit 2025 janë mbajtur gjashtë takime të rregullta, ku në këto takime ka marrë pjesë kryetari ose nënkryetari i komunës, komandanti i stacionit policor, përfaqësuesi i policisë kufitare (vija e gjelbër), përfaqësuesi i Këshillit të Bashkësisë Islame, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, përfaqësuesi për barazi gjinore, drejtori i Drejtorisë për Arsim, përfaqësuesi i Këshillit të Prindërve, përfaqësuesi i FSK-së, drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë, përfaqësuesi i KVRL-së. Siguria në komunën tonë, siguria në komunikacion, çështja e investimeve kapitale që i ka komuna dhe pronat të cilat i posedon, janë duke pësuar shumë dëmtime, siç po e shohim te parku i qytetit, parku "Bllaca 99", te parku te Ura e Seçishtës dhe dëmtimet tjera që po bëhen në vazhdimësi në prona publike, dhe është kërkuar prej policisë që të ketë një angazhim pak më të madh sa i përket kësaj çështjeje. I është rekomanduar policisë për çështjen e parkingut që është për persona me aftësi të kufizuara që të mos jetë i zënë. Është rekomanduar që policia të vazhdojë të qëndrojë në pikën te shkolla fillore "Ilaz Thaçi" në dy ndërrime është diskutuar çështja e dukurive negative edhe nëpër fshatra, si droga dhe bixhozi teknologjik, dhe është kërkuar nga policia që t'i njoftojë njësitet përgjegjëse të policisë për këtë çështje dhe të bashkëpunojë me qytetarë për këtë çështje. Nga Policia e Kosovës janë mbajtur nëpër shkolla ligjërata që kanë të bëjnë me sigurinë, si dhe ligjërata për dukuritë negative. Policisë i është rekomanduar që të ketë bashkëpunim të vazhdueshëm me qytetarët.

Menduh Vlasi thekson: është diskutuar për dukuritë negative dhe për çështje të tjera, por nuk ka informata kthyesë se a është ndërmarrë diçka, me përjashtim që është kërkuar të vendoset një shenjë te kufiri dhe është vendosur. Për të gjitha këto që i keni biseduar është mirë që vazhdimisht të kërkohet se a janë ndërmarrë hapa.

Sevdi Dernjani thekson: zakonisht kur i rekomandohet policisë, ata intervenojnë. Te çështja e parkingut përballë komunës kanë intervenuar, kanë intervenuar për qëndrimin te shkolla fillore. Diskutohen çështjet, pastaj në mbledhjen tjetër paraqesin edhe raporte, për të cilat policia raporton për të gjitha problemet që kanë ndodhur në lokalitet.

Menduh Vlasi thekson: e keni paraqitur problemin te parku që është dëmtuar, por a është zbuluar dhe a është ndërmarrë masë ndaj dikujt?

Sevdi Dernjani thekson: ne si komunë i kemi shprehur pakënaqësitë tona për investimet kapitale që i bëjmë, e që persona të papërgjegjshëm po i dëmtojnë, por i kemi rekomanduar policisë që duhet të ketë sa më shumë patrulla në këto zona. Mirëpo, ata arsyetohen që kanë mungesë stafi dhe nuk mundën t'i mbulojnë të gjitha zonat.

Kryesuesi thekson: u potencua çështja e vendosjes së shenjës në rrugë pa dalje, por kjo ka qenë kërkesë e mëhershme e jona, për të cilën banorët janë ankuar për shkak se harta e specifikon që andej është rruga, ndërsa në fakt nuk është. Është mirë që është vendosur shenja, por i njëjti problem është edhe te Lagjja Brava, në drejtim të rrugës së Lagjes Rana. Është mirë të shikohet kjo çështje, për shkak se shumë udhëtarë shkojnë nëpër oborre të banorëve, pasi mendojnë se është rrugë kryesore andej. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA PËR AKTIVITETE E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2025 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Propozim vendim për rritjen e buxhetit të NPL Pastrimi Sh.A.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson: është mirë ta diskutojmë këtë çështje për shkak se janë paraparë planifikimet buxhetore për vitin 2026 dhe nëse merret ndonjë vendim për rritjen e këtyre pagave, do të ketë një kosto që do të reflektojë në projektet e vitit 2026 dhe nuk e dimë se cilin projekt do ta heqim apo prej cilës drejtori do të merren mjetet financiare.

Kryesuesi thekson: ne do ta diskutojmë, por kjo do të varet prej mundësive buxhetore dhe mendoj që mund të realizohet.

Menduh Vlasi thekson: pagat a i marrin prej komunës apo prej të hyrave që i inkasojnë?

Sevdi Dernjani thekson: pagat i marrin prej të hyrave që i inkasojnë, mirëpo ata kërkojnë të rrisin buxhetin prej të hyrave të komunës, gjë që ndoshta mund të reflektojë në projektet tona.

Kryesuesi thekson: nuk besoj që ka ndonjë problem, për shkak se ashtu siç i kemi ndarë 80 000 €, i ndajmë edhe 20 000 €, sepse kanë nevojë punëtorët e kësaj kompanie dhe është e arsyeshme, sepse janë rritë edhe shpenzimet, e kompania nuk mund të mbijetojë.

Medina Imishti thekson: nëse nuk jam gabim, në mandatin e kaluar është marrë një vendim që varësisht prej rritjeve së pagave në nivel qendror të rriten edhe pagat e punëtorëve të kompanisë “Pastrimi”.

Kryesuesi thekson: nuk kam ndonjë informacion se është marrë ndonjë vendim për këtë çështje.

Nexhmedin Daci thekson: nuk mundet komuna që t’ua ngrisë pagat, por e vetmja mundësi është që ato të rriten përmes çmimeve të shërbimeve. Projektet kapitale nuk rrezikohen, sepse ne nuk mundemi prej projekteve kapitale me i nda mjetet për paga, por e vetmja mundësi është që me e shtuar numrin e shërbimeve apo rritjen e çmimeve, në mënyrë që me inkasuar më shumë mjete financiare dhe pastaj është kompania ajo e cila i ngrit pagat.

Kryesuesi thekson: për mos me i ngritur tarifat për qytetarët për pagesë, kemi menduar që të marrim vendim për rritjen e buxhetit për kompaninë “Pastrimi”. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PROPOZIM -VENDIMI PËR RITJEN E BUXHETIT PËR NPL “PASTRIMI” SH.A. QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson: për këtë pikë të rendit të punës hap diskutimin.

Menduh Vlasi thekson: kërkoj që të mbetet si pikë edhe informata e arsimit.

Kryesuesi thekson: ne u dakorduam që kjo të mbetet te të ndryshmet.

Menduh Vlasi thekson: te të ndryshmet mund të flasim, por kur ta kemi si informatë është pak më ndryshe. E bisedojmë këtë punë, sepse nëse është e vërtetë që janë tridhjetë nxënës, është dhjetë përqind e shkollës e përjashtuar, që i bie që në një shkollë të Prishtinës me u përjashtuar njëqind apo njëqind e pesëdhjetë përnjëherë. Unë e di pse janë përjashtuar, por do ta bisedojmë në Kuvend.

Sevdi Dernjani thekson: në rregull, e diskutojmë. Nëse është një çështje që dihet si fenomen, që ne të gjithë e dimë për çka kemi nevojë me bërë temë dhe me e zmadhuar më shumë, mirëpo nëse bie një alternativë dhe ne mundemi me e zbatuar e nuk e zbatojmë, krejt në rregull. Nëse e ke sjellë ti si drejtor i arsimit, që ke qenë edhe më herët duke punuar në arsim, dhe e sjell një lloj elaborati që duhet të veprohet në këtë drejtim, e ne nuk po e zbatojmë dhe po ndodhin këto gjëra, unë pajtohem plotësisht. Ndërsa me diskutu si fenomen dhe me përfitu në kurriz të një diçkaje që është e pahijshme, më duket shumë banale dhe, nëse bëni politikë në këtë çështje, nuk më duket e moralshme. Nëse ka diçka që fitojmë dhe mundemi me përparu, në rregull e diskutojmë dhe mund ta diskutojmë në Kuvend.

Kryesuesi thekson: askush nuk është duke e akuzuar kryetarin apo nënkryetarin pse është duke ndodhur kjo, por kjo çështje duhet të diskutohet, sepse është një dukuri që na kaplon të gjithëve. Është mirë me u shikuar se ku është problemi, në mënyrë që me menduar me e eliminu këtë çështje, sepse nëse vazhdohet në këtë mënyrë, nga tridhjetë nxënës është shqetësim për ne, dhe ndoshta mund të jetë rrezik që edhe shkolla të mbyllet për shkak se nuk ka nxënës. Është mirë që të shterren të gjitha mundësitë para se të përjashtohet një nxënës, për të parë pse është duke u përjashtuar, e jo nëse i tekton ndonjë arsimtarit apo profesorit se nuk mund ta durojë një nxënës, pastaj e përjashton.

Nexhmedin Daci thekson: nuk është lehtë me përjashtu, sepse ka të drejtën e ankesës, ndërsa ata që e meritojnë nuk kemi çka me ju bërë; a duhet me u lut që hajde kaloni të gjitha klasat dhe pastaj me zënë një vend në komunë?

Sevdi Dernjani thekson: ky fenomen ka qenë edhe në të kaluarën edhe tash, por ndoshta është në masë më të madhe, që me reflektu dikush për me bë politikë, por kjo është diçka tjetër. Në bazë të diskutimeve që i kam pasur me drejtorin, nëse një nxënës i ka 100 mungesa brenda vitit, nuk mundet me u obligu me ardhur, por mund të sillt një alternativë në bazë të dispozitave ligjore.

Kryesuesi thekson: si pikë të rendit të ditës nuk mundemi me e shti, për shkak se sot duhet të përcillet materiali për Kuvend.

Menduh Vlashi thekson: e përcjellim me material shtesë.

Kryesuesi thekson: është problem dhe në Kuvend e diskutojmë.

Sevdi Dernjani thekson: diskutoje si z. Basri Dernjani, e qet në KPF dhe pastaj e shtin edhe në Kuvend.

Menduh Vlashi thekson: është e drejtë me shtu ose me hek pika të rendit të ditës dhe, nëse shumica janë që mos me hy si pikë, ti mundesh me e qit në votim. Nëse shumica e KPF-së janë që mos me hy si pikë, mua nuk më pengon kjo punë, por nënkryetari mos të thotë që bëj politikë, sepse është shqetësuese për Hanin e Elezit dhe unë dua me pas informata për arsyen e përjashtimeve, sepse nuk e di.

Sevdi Dernjani thekson: mos më keqkupto, se ju po thoni që unë e di, por unë po dua me diskutu në Kuvend, që i bie me diskutu në publik për një dukuri negative që po e përkeqëson edhe më shumë. Unë të thashë: hajde me një rekomandim si ish-drejtor i arsimit, sill një plan-program si asamblast që je dhe prezantoja drejtorit të arsimit; nëse ai nuk ta zbaton, atëherë ke të drejtë me bërë politikë. Ndërsa me diskutu dhe me potencu që i di të gjitha këto probleme dhe prapë me insistu, është e drejta jote.

Kryesuesi thekson: si informatë ka me na ardhë në Kuvend.

Menduh Vlashi thekson: qite në votim dhe nëse është shumica, të hyjë si pikë, sepse kjo duhet të jetë si pikë.

Kryesuesi thekson: edhe unë jam pro kësaj çështjeje që të diskutohet në Kuvend, për të parë se çka është më e mira për ato fëmijë dhe për ne në përgjithësi. Por këtu nuk e kemi drejtorin dhe pastaj mund të thoni pse nuk është përcjellë materiali me kohë, sepse materiali duhet të përcillet sot për Kuvend. Dhe nuk e qes në votim, në mënyrë që t'i lëmë hapësirë drejtorit, që të mos arsyetohet se ka pasur apo jo kohë; t'i lëmë hapësirë, pra ta njoftojmë paraprakisht.

Menduh Vlashi thekson: nëse nuk e qet si pikë, ai nuk ka obligim me ta sjellë materialin. Është e drejta ime, është e drejta e KPF-së, unë propozoj me heq një pikë ose me shtu, dhe si kryesues e ke për detyrë me e qit në votim, dhe ju jeni shumicë.

Kryesuesi thekson: në mbledhjen tjetër e diskutojmë këtë çështje.

Menduh Vlashi thekson: nuk është në rregull, duhet me e qit si pikë.

Kryesuesi thekson: nëse drejtori potencon që nuk i ka mjaftuar koha.

Menduh Vlashi thekson: nuk është problem e shtijmë për mbledhjen tjetër, por si pikë duhet me mbetur dhe na të mbetet dobësi e drejtorit pse nuk na e ka përcjellë materialin e jo e jona.

Kryesuesi thekson: ne e shtimë si pikë, por unë po mundohem edhe drejtorit me ia dhënë hapësirë për shkak se kjo është shqetësim dhe nuk është vetëm për ty, por është shqetësim edhe për ne, por nuk mundeni me ia drejtuar gishtin Kryetarit apo Nënkyetarit që ju jeni tu e bërë, për shkak se kjo është vazhdimësi dhe gjithmonë është përsëritur. Ne duhet të bëhemi bashkërisht me i shikuar mundësitë tona në mënyrë që me mundur me parandaluar këtë çështje.

Menduh Vlashi thekson: mos më keqkuptoni që e kam qëllimin as Kryetarin as drejtorin e shkollës, sepse kjo është dukuri. Nënkyetari potencoi që me bërë një propozim, por ne do ta diskutojmë në Kuvend dhe unë do t'i paraqes arsyet që unë mendoj se vjen deri te kjo, dhe nëse ju pajtoheni me ato arsye që janë të vërteta mirë, por nëse jo, asgjë nuk kërkoj sepse unë i kam potencuar. Nëse me të vërtetë ekzistojnë këto arsye që unë mendoj, e që ka arsye që edhe unë nuk i di, atëherë e lëmë ashtu dhe në vitin tjetër i përjashtojmë edhe dyzet apo pesëdhjetë edhe e mbyllim krejt.

Visar Hasallari thekson: është e drejtë e neve anëtarëve me propozuar, por është puna jote si kryesues me e qitë në votim. Edhe propozimi i z. Basri Dernjani edhe propozimi i z. Menduh Vlashi vetëm u diskutuan dhe nuk u votuan dhe duhet të votohen.

Kryesuesi thekson: propozimi i z. Basri Dernjani u votua për me hy si pikë.

Visar Hasallari thekson: për pikën që e ka propozuar z. Basri kërkoj tërhiqem, mirëpo për pikën të cilën e propozoi z. Menduh Vlashi nuk e votuam për me ardhur në Kuvend.

Kryesuesi thekson: z. Visar Hasallari, a jeni për me votuar këtë pikë të rendit të punës?

Visar Hasallari thekson: qiten në votim sepse është tu u propozuar dhe ne jemi për me votuar për me ardh në Kuvend, për shkak se nesër unë e jap një propozim dhe duhet të votohet për me ardh në Kuvend, për shkak se është me statut dhe me rregullore të Kuvendit se si propozohet një pikë pa u votuar në KPF.

Kryesuesi thekson: pikat mund të propozohen edhe pa hyrë në KPF në Kuvend, por ju e diskutuat dhe ishit të një mendimi që të përcillet për Kuvend dhe të gjithë një mendim për atë e lash. Atëherë pse nuk reagoje, heshtja është pranim.

Visar Hasallari thekson: ne vetëm e diskutuam dhe nuk e votuam për Kuvend.

Kryesuesi thekson: pse nuk reagoje, ke mundur me reagu.

Visar Hasallari thekson: ato që deshta me potencuar i potencova z. Menduh Vlashi.

Kryesuesi thekson: pasi po insistoni, atëherë kush është për propozimin e z. Menduh Vlashi – Informatë mbi përjashtimin e nxënësve në shkollën e mesme “Dardania”, rezultati i votimit ishte njëzëri. A keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 11:55.

Procesmbajtësi
Ayni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

